



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.01.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Damian Gjiknuri, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Elena Xhina, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Silva Caka dhe Nasip Naço.

Mungojnë:

Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Taulant Balla - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Ervin Bushati - Sekretar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i mjaftueshëm për të vazhduar me rendin e ditës.

Sot në rendin e ditës kemi vetëm një çështje, shqyrtimin e projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Sipas vendimit të Konferencës së Kryetarëve të datës 22.11.2018, komisioni ynë do të jetë komision përgjegjës në shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektvendimi. Sot do të kemi vetëm shqyrtimin dhe miratimin në parim të ndryshimeve në Rregullore. Ky projektvendim është propozim i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Për të bërë prezantimin e këtyre ndryshimeve, që kërkohet t'i bëhen Rregullores, sot kemi prezentë kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zotin Balla, dhe sekretarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zotin Bushati. Relator i këtij projektvendimi është zonja Vasilika Hysi.

Për të bërë një prezantimin e këtyre ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, unë do t'ia kaloj fjalën zotit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për procedurë fjalën e ka zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj - Zoti Manja,

Të nderuar deputetë,

Dje ka ardhur njoftimi nga sekretaria e komisionit me këtë rend dite që ju sapo thatë, pra për paraqitjen e një ndryshimi në Rregulloren e Kuvendit. Ju sapo shpjeguat që Konferenca e Kryetarëve paska ngarkuar Komisionin e Ligjeve për të shqyrtuar ndryshimet eventuale në Rregulloren e Kuvendit. Ju jeni të qartë, por unë dua t'ju kujtoj se Rregullorja e Kuvendit, që është në fuqi, në nenin 13, pika 2, të saj përcakton se çdo propozim për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit është kompetencë, sipas praktikës dhe sipas procedurës së brendshme të këtij Kuvendi, jo e Komisionit të Ligjeve, por e një organizmi tjetër brenda Kuvendit, që është Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Unë besoj se me një numër kaq të madh juristësh dhe deputetësh me disa mandate, për shkak edhe të praktikës, traditës, por, mbi të gjitha, për shkak të Rregullores, nuk është në kompetencën e këtij komisioni që të shqyrtojë ndryshimet e Rregullores. Çdo ndryshim eventuale i Rregullores së

Kuvendit, i aktit themeltar të këtij parlamenti, është në kompetencën e një organi tjetër, siç e thashë, Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Sigurisht, ka një ndryshim, dhe ju këtë e dini, që raporti në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin është i barabartë, 5 nga maxhoranca dhe 5 nga opozita, gjë që nuk është kështu në Komisionin e Ligjeve. Në fakt, kjo shkon me logjikën dhe me traditën e këtij parlamenti, që çdo ndryshim në Rregulloren e Kuvendit, për shkak të këtij parashikimi, duhet ta shqyrtojë Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Edhe për shkak të traditës, tashmë 30-vjeçare, të këtij parlamenti, ndryshimet kalojnë me konsensus dhe me votë të barabartë. Kërkesa ime është që duhet ta hiqni këtë pikë nga rendi i ditës, pasi është një lapsus, është një gabim në rastin më të mirë të Konferencës së Kryetarëve, që e ka sjellë si lëndë pranë Komisionit të Ligjeve, dhe t'ia kalojmë eventualisht, nëse gjithmonë do të keni dëshirë, mbledhjes më të afërt të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, që i takon Kryetarit të Kuvendit ta thërrasë.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Alibeaj!

Në fakt, nuk është lapsus, është pikë për pikë ajo që ka vendosur Konferenca e Kryetarëve. Shqyrtimi i projektvendimit për ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit janë pjesë e kalendarit të punimeve edhe të Kuvendit të Shqipërisë, por edhe të Komisionit të Ligjeve për periudhën 21 janar - 8 shkurt, të cilën ne e kemi miratuar në komision. Për t'ju dhënë një përgjigje lidhur me zbatimin e nenit 13, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, besoj se është e qartë për mediet, por edhe për opinionin publik.

Kuvendi ka pasur detyrimin që t'i shqyrtojë ndryshimet në Rregullore që në sesionin e vjeshtës së vitit 2018, por ju e dini shumë mirë bojkotin që i bëtë sesionit të vjeshtës dhe e bllokuat punën në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Për rrjedhojë Konferenca e Kryetarëve, nisur nga kjo situatë, në mbledhjen e datës 22.11.2018, ka vendosur që shqyrtimin e propozimeve për ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit dhe përgatitjen e raportit për seancë plenare t'ia kalojë Komisionit të Ligjeve të Kuvendit. Pra, as më shumë dhe as më pak, në zbatim të këtij detyrimi, që buron nga kjo vendimmarrje e një organi të rëndësishëm të Kuvendit, siç është Konferenca e Kryetarëve, kam futur në rendin e ditës shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtyre ndryshimeve në draftregullore. Çdo pretendim juaji për zbatimin e nenit 13 të Rregullores së Kuvendit, në fakt, nuk duhet t'i adresohet kësaj tryeze, por Konferencës së Kryetarëve. Unë sot jam në zbatim të këtij vendimi të Konferencës së Kryetarëve dhe besoj se deri këtu jam shumë korrekt me zbatimin e Rregullores së Kuvendit.

Zoti Balla, fjala është për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zonja Hysi, për procedurë.

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, unë do të doja të sillja në vëmendje të shqetësimit që ngriti kolegu, që në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve kanë qenë të pranishëm edhe vetë përfaqësuesit e opozitës, madje ata kërkuar që miratimi i ndryshimeve të Rregullores të shtyheshin në muajin janar, pasi Konferenca e Kryetarëve e kishte planifikuar që të përgatitej shqyrtimi dhe raporti për datën 20 dhjetor. Ne sot jemi në fund të muajit janar dhe me këtë rast besoj se jemi brenda përmbushjes së kërkesave, që erdhën nga kryetarët e grupeve parlamentare të opozitës, të cilët i falënderoj për vullnetin që shprehën dhe i besuan Komisionit të Ligjeve shqyrtimin e amendamenteve të Rregullores së Kuvendit.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zoti Alibeaj, dhe më pas do ta hedhim në votë propozimin.

Enkelejd Alibeaj - Po, është e vërtetë që kemi kërkuar të shqyrtohet në janar, por jo nga Komisioni i Ligjeve, sepse Konferenca e Kryetarëve nuk e përcakton që të ndryshojë Rregulloren siç do Gramozi me shokë, por për kalendarin ramë dakord. Në fakt, zonjë, ti duhet ta dish që ne bashkë kemi punuar rreth një vit më parë dhe ky është një shembull që tregon gjithmonë në dëshirën tonë për ta ndryshuar për mirë Rregulloren. Madje, po ju kujtoj edhe faktin se në Kodin e Sjelljes, që ishte një kusht vjet në qershor, një kontribut i përbashkët yni dhe një falënderim për këtë duhet ta kishit bërë minimalisht, ndërsa sot ajo çfarë ju po thoni është se e keni caktuar që ta shqyrtojë Komisioni i Ligjeve.

Pra, as më pak dhe as më shumë, po thoni se doni që ta miratoni vetë, duke prishur traditën 30-vjeçare të parlamentit, duke shkelur Rregulloren, nenin 13, që e thotë e zeza mbi të bardhë, që organizmi i vetëm brenda Kuvendit që duhet të shqyrtojë çdo dëshirë për të ndryshuar është Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Kjo gjë është kaq e thjeshtë, është kaq traditë, është kaq e pastër, sa që unë vërtet mendova se ishte lapsus, por tani u binda që nuk është lapsus. Unë dua të di: cila është arsyeja që ju shtyn për ta kaluar në mënyrë të njëanshme, në shkelje të Rregullores, në manipulim të mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve? Unë kam përshtypjen se kur t'i japësh fjalën zotërisë që është përballë, çdokush duhet ta marrë vesh se cila është arsyeja. Unë nuk doja që ta thosha në këtë moment, por nuk ju bën nder se jeni përgjëruar gjithmonë që ta keni opozitën në parlament, apo jo? Në çdo seancë ju keni thënë: "Ku është opozita? Pse nuk vjen opozita? Pse bojkoton opozita?" dhe ditën e parë që opozita vjen në komision, e prisni me këmbët e para. Shkurt, ju doni të miratoni në parlament ndryshime në Rregullore, dhe për këtë qëllim dhe synim të vetëm, pra

pse po e kaloni në Komisionin e Ligjeve, në kundërshtim me Rregulloren, keni rikthimin edhe një herë të imunitetit sot, me ndryshimet e propozuara nga zotëria atje.

(Diskutime pa mikrofon.)

Prandaj, unë ju thashë me shumë dashamirësi, pa e kaluar në debat shterpë. Unë e di fare mirë që ky parlament nuk e ka respektuar këtë Rregullore, sepse ju ia hiqni fjalën opozitës në mes të seancës parlamentare, juve nuk respektoni asnjë nga urdhrat e Kushtetutës, as të Rregullores, siç duket, ju ka mbetur vetëm një gjë, të cilën nuk e mbroni dot, që është çështja e imunitetit të deputetëve. Meqenëse ra fjala, kush e ka radhën? Kjo që po bëni ju sot, është se doni të fusni edhe një herë çështjen e imunitetit, që është hequr nga Kushtetuta në vitin 2012. A e mbani mend se çfarë qëndrimi keni mbajtur në atë kohë kur ishit në opozitë? Ju nuk donit që ta hiqnit imunitetin, kurse sot po e fusni me dhunë në Rregullore. Kush ka frikë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja - Ju lutem, të mbarojë zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj - Më lini të mbaroj se ky është argumentimi i gjësë. Ju po fusni sot edhe një herë koherencën imunitare për të mbrojtur deputetë nga ndjekja penale. E kapët Prokurorinë e Përgjithshme me Arta Markun, e kapët Prokurorinë e Krimeve të Rënda me Donika Prelën, e kapët Këshillin e Lartë të Prokurorisë me Gent Ibrahimin dhe me të gjitha gjërat që po diskutohen aty dhe ende jeni të frikësuar, prandaj doni ta vendosni imunitetin edhe në Rregullore! Kaq shumë keni vjedhur?! Kaq shumë ju ka zënë frika?!

Ulsi Manja - Ju lutem, duhet ta mbyllni për procedurë, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj - Kjo është procedura: arritja e madhe e reduktimit të imunitetit, sepse ju u bëtë pengesë në vitin 2012 nga Kushtetuta dhe po ju doni ta fusni sot nga dritarja në Rregullore, duke shkelur procedurën.

Ulsi Manja - Ne nuk e kemi filluar ende.

Enkelejd Alibeaj - Por unë di të lexoj, se ky material është shpërndarë.

Ulsi Manja - Nuk kemi filluar ende, megjithatë mbylleni për procedurë.

Enkelejd Alibeaj - Ky është një material, që është shpërndarë dhe është një material që nuk ka marrë formën përfundimtare, kështu që për ta filluar me këmbë të mbarë, meqenëse gjithë këtë kohë përmendët edhe çështjen e bojkotit. Ja pra kjo është çështja e bojkotit, se nuk erdhëm pikërisht për këtë arsye, për t'i rënë kambanës së madhe se si ky parlament, se si ky pushtet, kjo maxhorancë është e lidhur me krimin. Sot ditën e parë ju tregoni edhe shembullin e madh se deri ku ka shkuar frika juaj nga ndjekja penale, sepse doni të fusni edhe një herë imunitetin. Ky është turp i madh, të rikthehesh sot në rudimentet e para vitit 2012.

Ulsi Manja - Të lutem, zoti Alibeaj

Enkelejd Alibeaj - Kërkesa ime është shumë e qartë: duhet hequr nga ky moment nga rendi i ditës së Komisionit të Ligjeve dhe të kalojë tek ai organ, që e ka në kompetencë, te Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, aty mund të bëni çfarëdolloj kërkesë të mundshme.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Sa për sqarim dhe për të sjellë në vëmendjen e kolegëve të Komisionit të Ligjeve, por edhe të opinionit publik, nuk është hera e parë që ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit miratohen në Komisionin e Ligjeve, sepse ka edhe precedentë parlamentarë ky Kuvend. Ju sjell në vëmendje ndryshimet e vitit 2005, që i janë bërë Rregullores me vendimin nr. 15 në Komisionin e Ligjeve, në vitin 2010 me vendimin nr. 41, datë 24.06. 2010 po Komisioni i Ligjeve ka bërë ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, me vendimin nr. 88, datë 24.02.2011 përsëri ka qenë Komisioni i Ligjeve që ka bërë ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë dhe ishte koha kur këta zotërinjtë ishin në pushtet dhe ishin shumicë. Mirëpo ndryshimi i kaheve dhe i pozicioneve në këtë tryezë bën që të ndryshojë edhe ligji.

Në fakt, unë nuk kam një kërkesë nga nënkryetari i komisionit, zoti Alibeaj, dhe do ta hedh në votim, sepse nuk mund të vazhdojmë debatin a ka të drejtë Komisioni i Ligjeve apo nuk ka të drejtë, sepse përpos vendimmarrjes së Konferencës së Kryetarëve ka edhe këto precedentë parlamentarë, që janë të kohës së këtyre, nuk janë të kohës sonë kur ishim në shumicë.

E hedhim në votim propozimin e kolegut Alibeaj.

Kush është dakord me propozimin e kolegut Alibeaj? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet propozimi i kolegut Alibeaj.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem lexoni vendimin nr. 15, datë 27.12.2005, shikoni vendimin nr. 41, datë 24.06.2010 dhe vendimin nr. 88, datë 24.02.2011.

Gent Strazimiri - Në qoftë se Këshilli i Rregullores dhe Mandateve ia delegon Komisionit të Ligjeve...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja - Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për të bërë një prezantim në parim të ndryshimeve që propozohen në Rregullore.

Fjala është për zotin Balla.

Taulant Balla – Faleminderit, zoti kryetar dhe ju anëtarë të Komisionit të Ligjeve!

Që në fillim dua të them se këto ndryshime nuk miratohen pa konsensusin e opozitës. Mos u shqetësoni, se ne nuk do të miratojmë kurrë ndryshime në Rregullore pa konsensusin e opozitës, sepse nuk do të bëjmë gabimet që ka bërë Kuvendi në vitin 2010 dhe në vitin 2011.

Në vitet 2010 dhe 2011 Kuvendi miratonte pa konsensus. Nuk miratohet kurrë Rregullorja e Kuvendit pa konsensusin tuaj. Tani, që ta sqarojmë dhe ta dijë edhe opinioni publik, materiali që keni para ka 6 nene të propozuara nga ne dhe 12 nene të propozuara nga Partia Demokratike. Pra, dyfishi i neneve janë propozuar nga Partia Demokratike. Ka ardhur dita që unë të vij të mbroj edhe propozimet e Partisë Demokratike, por ka ardhur si pasojë e bojkotit parlamentar të tejzgjatur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zotin Alibeaj dua ta falënderoj për të gjithë punën e mirë që kemi bërë së bashku, madje edhe në këtë sallë këtu zotit Alibeaj i kam shprehur garancinë dhe gatishmërinë tonë që neneve që u referohet zoti Alibeaj të mos preken fare dhe të prevalojë ajo që është parashikuar në Kushtetutë për sa i përket imunitetit. Megjithatë, për teknikë legjislative, të paktën në këtë sallë të gjithë e dimë që gjithmonë prevalon Kushtetuta dhe çfarë është parashikuar në Kushtetutë duhet të transformohet në Rregullore. Qëllimi për të cilin kemi ardhur këtu është pikërisht nevoja që pas 15 vjetëve, nga viti 2004, libri i rregullave të Kuvendit të Shqipërisë duhet të abdejtohet, së pari, me ndryshimet Kushtetuese, së dyti, me vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe, së treti, me rekomandimet e Komisionit European dhe të GRECO-s, të cilat për ne janë dokumentet referenciale për të garantuar një rregullore të mirë.

Së pesti, doja të shtoja, të dashur kolegë dhe ju përfaqësues të medieve që na ndiqni, ne kemi një Rregullore Kuvendi shumë të vjetër. Për t'jua lehtësuar, është një Rregullore Kuvendi që nuk përcakton ditën se kur mbledhet Kuvendi i Shqipërisë. Ka mbetur si traditë që Kuvendi i Shqipërisë mbledhet ditën e enjte në orën 10:00, por në Rregulloren e Kuvendit kjo nuk shkruhet asgjëkundi. Ajo që është më e rëndësishme dhe që nuk do të flitej kurrë, nëse unë do të isha në vendin e zotit Alibeaj dhe ai do të ishte në vendin tim, është sigurisht dëshira jonë që ky proces të zhvillohej bashkë me opozitën. Kodi i Sjelljes së Deputetëve reflektoi pothuajse të gjitha propozimet që erdhën nga Partia Demokratike dhe më e domosdoshme është që edhe përmbajtja e Kodit të Sjelljes të vijë te Rregullorja e Kuvendit. Për t'i qartësuar ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, qoftë nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, por qoftë edhe nga komentet e bëra nga opozita, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, si dhe nga Shërbimet Administrative të Kuvendit, edhe një herë theksoj se aty

ku janë ndaluar në datën 2 prill të viti 2018, me komentet që janë bërë edhe këtu në këtë sallë, ne të dy, pa praninë e medieeve, se kur jemi pa medien ne merremi vesh dhe vetëm kur vijnë mediet nuk merremi vesh, kemi rënë dakord që të ruajmë nenet 118 dhe 119, siç janë dhe me prevalencën që ka Kushtetuta. Sigurisht, për ne është e rëndësishme që rekomandimet e projektit IPA, paratë e taksapaguesve europianë, që kanë asistuar Kuvendin për vite me radhë, të merren në konsideratë, po ashtu reflektohen në Rregullore rekomandimet e GREKO-s të vitit 2018.

Puna e bërë deri më tani ka sjellë një situatë të tillë. Pra kemi propozimin fillestar me 6 nene të Grupit të Partisë Socialiste dhe propozimin me 11 nene të Grupit të Partisë Demokratike për rishikimin tërësor të kreut të Rregullores, që lidhen me rregullin dhe sjelljen në Kuvend. Këto janë parashikime të dakordësuara e të reflektuara në Kodin e Sjelljes dhe në Rregullore, dhe propozime për programimin e veprimtarisë parlamentare. Procedurat e konstatimit të kufizimeve janë në një nen, gjithashtu 12 nene janë propozime nga administrata e Kuvendit me natyrë teknike. Kjo është panorama.

Cila është më e rëndësishme në këtë fazë të ndryshimeve të Rregullores së Kuvendit? Ne jemi i vetmi Kuvend ose ndër të rrallët që nuk kemi një javë të dedikuar tërësisht zgjedhësve. Këtë risi ne do ta sjellim, sepse e gjithë vëmendja është për njerëzit. Pra, nuk mund të bësh ligje të mira dhe nuk mund të sjellim në Kuvend refleksionet dhe problematikat e qytetarëve, nëse nuk u dedikojmë atyre që na kanë sjellë këtu një javë të plotë takime me ta. Në ndryshimin e strukturës së programit të Kuvendit është sjellë për herë të parë java e dedikuar zgjedhësve.

Në vlerësimin tim ky është ndryshimi më i madh në këtë Rregullore, sepse varianti që deputetët duhet të takojnë zgjedhësit ditët e premte dhe të shtunë nuk funksionon më.

Në dialog me Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike kemi rënë dakord që pas javës së dedikuar zgjedhësve, të ketë një seancë parlamentare dedikuar problemeve të tyre. Ajo seancë zhvillohet ditën e hënë, menjëherë pas javës së dedikuar zgjedhësve dhe do të zgjasë katër orë, të ndara pothuajse në mënyrë të barabartë mazhorancë, opozitë, sipas përqindjes që i takon çdo grupi parlamentar. Çdo deputet do të sjellë problematikat që ka konstatuar, pastaj u takon ekspertëve të caktojnë nëse duan të futen në pjesën e minutazhit. Seancën e pyetjeve dhe përgjigjeve e kemi të përcaktuar, megjithatë kjo mund të jetë një seancë ku mund të bashkohen, por kjo ju takon juve të vendosni, sepse ju jeni vendimmarrësit për këtë çështje.

Për sa u përket dispozitave të posaçme në Rregulloren e Kuvendit për procesin e integritetit europian, ku Shqipëria është e angazhuar, në vitin 2015 kemi miratuar ligjin “Balla

– Bregu”, quajeni si të doni, për rolin e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integrimit në Bashkimin Europian, por nuk janë të reflektuara në Rregullore ato që janë në ligj. Kemi ngritur Këshillin Kombëtar të Integrimit Europian, ku kryetari i saj i takon opozitës, gjithashtu edhe kryetari i Komisionit të Integrimit Europian, sipas traditës, i takon opozitës. Por të gjitha këto duhet të reflektohen të menjëherë në Rregullore.

Gjej rastin të them, ashtu siç e bëra në Komisionin e Integrimit, që është lajm i mirë që opozita është në Kuvend në këta 6 muaj të rëndësishëm të rrugës sonë europiane, sepse realisht vendi juaj është këtu në Kuvend. Ne bëjmë debate, votoni kundër ose pro dhe, në fund të fundit, secili kryen detyrën e vet. Por edhe këtu janë disa rekomandime të cilat duhen parë.

Tani të shikojmë 25 rekomandimet e projektit IPA. Për komponentin e parë janë 3 rekomandime, për të dytin janë 15 rekomandime dhe për të tretin janë 2 rekomandime, të cilat kanë të bëjnë me draftligjin e përgatitur për pavarësinë buxhetore. Ky është një rast shumë i rëndësishëm.

Pavarësia buxhetore e Kuvendit është bërë me konsensus të plotë me Partinë Demokratike. Jemi institucioni që miratojmë pavarësinë buxhetore për një sërë institucionesh të tjera dhe padrejtësisht në shkelje të plotë të Kushtetutës së vendit Kuvendit të Shqipërisë buxhetin ia miraton Ministria e Financave. Kjo do të thotë se është bërë një punë e shkëlqyer nga zoti Bushati, zoti Mima, zoti Angjeli dhe nga kolegët e tjerë të opozitës, për të kaluar në një fazë tjetër që ka si pikësynim fundor transparencën e plotë të çdo qindarke që harxhohet për Kuvendin dhe për deputetët. Pra, historia që deputetët të përçudnohen publikisht për shkak të mungesës së transparencës do të marrë fund. Draftligji për pavarësinë buxhetore, i cili duhet të vijojë pas ndryshimeve të kësaj Rregulloreje dhe Kodit të Sjelljes së Deputetëve do të ishte hap themelor. Pra, pas 20 vjetësh duhet të ndryshojmë tërësisht ligjin për statusin e deputetit. Kemi një ligj, që unë e quaj të fortë, por të pazbatuar deri më sot, por ka ardhur koha që Shqipëria është republikë parlamentare, ku deputetët dhe Kuvendi i Shqipërisë janë autoritet i rëndësishëm si në miratimin e ligjeve, por edhe në monitorimin e qeverisjes dhe implementimin e tyre.

Rekomandimet e GREGO-s. Vendosja e referencave në Rregulloren e Kuvendit në masat respektive disiplinore edhe në rastin e shkeljes të parashikuar në Kodin e Sjelljes, të cilin nuk e bëjmë dot të implementueshëm nëse nuk e referojmë në Rregullore, sepse Byroja e Kuvendit është e detyruar. Kjo është bërë gjithmonë për të lehtësuar dhe jo për të shtrenguar masat. Këto kanë, nga dialogu dhe bisedat që kemi zhvilluar së bashku në prill të vitit 2018.

Përputhja e Rregullores me Kodin e Sjelljes. Edhe këtë e theksuam, sepse parashikimi i të drejtës për ankimim ndaj vendimit të Byrosë së Kuvendit është një çështje që e kemi diskutuar.

Ky material pune më 15 tetor të vitit 2015 u vendos në dispozicion të Të gjitha grupeve parlamentare dhe, pavarësisht bisedave që kemi zhvilluar në një kohë të gjatë, me një numër të madh deputetësh të opozitës, kjo me qëllim që e gjithë kjo frymë pozitive, që nuk ka të bëjë fare me atë që thatë ju dhe këtë gjë e dini shumë mirë, nuk kalon pa dakordësinë tuaj dhe nenet që ju i referoheni të qëndrojnë siç janë.

Anëtarët e Komisionit të Këshillit të Mandateve në rastet kur do të funksionojë, ju e dini, nuk i janë referuar Rregullores, por i janë referuar Kushtetutës, edhe në rastet që na kanë paraprirë apo edhe në rastet që do të vijnë.

Më lejoni të jem i sqartë, ky kuvend duhet të ketë vetëm dy grupe parlamentare opozitare, sepse kjo histori që deputet të Partisë Demokratike transferohen për të formuar Partinë Republikane nuk duhet të vazhdojë më, sepse e keni shkelur Rregulloren dhe ka një kosto. Është e padrejtë që shqiptarët të paguajnë kosto për të mbajtur grupin parlamentar të Partisë Republikane kur nuk ka asnjë republikan të votuar nga shqiptarët në vitin 2017. Pra nuk është e drejtë për të paguar 30 milionë lekë në vit për të mbajtur këtë grup parlamentar.

Më 22 nëntor të vitit 2018 u zhvillua mbledhja e Konferencës së Kryetarëve me të tria grupet parlamentare, e cila vendosi për shqyrtimin e propozimeve të ndryshimit të Rregullores së Kuvendit, referuar edhe praktikës së mëparshme. Më besoni që e keni gabim, sepse nuk ka qenë Komisioni për Çështje Ligjore, të Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut ratifikues i asaj çfarë ka vendosur Këshilli i Rregullores, përkundrazi, në mungesë të anëtarëve të Këshillit të Rregullores dhe Mandateve i është kaluar këtij institucioni kaq të rëndësishëm në burokracinë organizative të Kuvendit. Ky komision do të shqyrtonte propozimet dhe do të përgatiste raportin për seancën plenare. Në Konferencën e Kryetarëve që i parapriu seancës plenare, me lajmin e mirë për afrimin e 6-mujorit kushtetues të përfundimit të mandatit të deputetëve, ramë dakord që këtë çështje ta shtyjmë për miratim në sesionin e ri parlamentar, pra më 21 janar.

Dokumenti që keni përpara ka 65 nene, prandaj dua të jetë transparente për publikun. 6 nene janë propozim i Partisë Socialiste, 13 nene janë propozim i Partisë Demokratike, 24 nene janë reflektim i 25 rekomandimeve të projektit IPA të BE-së, 2 nene janë reflektime të rekomandimeve të GREKO-s, 2 nene janë reflektime të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për agjendën e vitit 2013 të miratuar me konsensus të plotë, në mos gaboju ka qenë PS-PD, nuk e di nëse ka marrë pjesë LSI-ja atë ditë, por nuk ka rëndësi, 3 nene

në përputhje me Kodin Zgjedhor janë propozime nga stafi i Kuvendit, 4 nene janë reflektim i rekomandimeve të progresraportit të Komisionit European të vitit 2018, 7 nene janë propozime nenesh të munguara nga stafi dhe 5 nene janë propozim për aspekte teknike, siç i citova.

Pra, Partia Socialiste nuk ka propozuar asnjë të dhjetën e neneve, shto këtu edhe ato që thoni ju.

Zoti kryetar, të hiqen ato propozime të transpozuara fjalë për fjalë nga Kushtetuta në nenet 118 dhe 119, ose të qëndrojnë ashtu siç janë ose të shkruhen siç kërkon opozita. Ato nene i keni në fletë të bardhë, shkruajini si të doni dhe pastaj t'i miratojmë.

E fundit, sa të jemi ne si shumicë, ndryshimet në Rregullore gjithmonë do të miratohen me konsensus të plotë me opozitën, sepse dua t'ju rikujtoj nevojën që nesër në seancë plenare të votojmë së bashku, "siç janë rregullat e lojës në Kuvend", po kështu edhe Kodi Zgjedhor është një libër rregullash për zgjedhjet. Kodin Zgjedhor e keni në fletë të bardhë, shkruajeni si të doni dhe ne jemi të gatshëm ta votojmë që nesër në Kuvend.

Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Balla!

Fjalën do t'ia kaloj relatores, koleges Hysi, për të bërë një prezantim të ndryshimeve që propozohen. Pastaj, sipas Rregullores, kalojmë në pyetje dhe diskutime nga deputetët.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe kryetarit të grupit, pasi më lehtësoi dhe shkurtoi prezantimin.

Rregullorja e Kuvendit ka ndryshuar 8 herë që nga momenti i miratimit të saj me konsensusin e të gjitha forcave politike dhe me asistencën e prezencës së OSBE-së në vitin 2004.

Ju me të drejtë e thatë që ndryshimet e shpeshta të bërë në vitin 2005, 2010 dhe 2011 janë bërë pa proces konsultimi dhe nuk janë votuar me konsensus. Ndryshimet e bëra në vitin 2013 me vendimin nr. 41 janë bërë me konsensus të forcave kryesore politike dhe ndryshimet e bëra në vitet 2014 dhe 2017 të miratuara me vendimet nr. 95 dhe 88, janë miratuar me mirëkuptim dhe kanë qenë të natyrës organizative.

Në fakt, Rregullorja ka një traditë dhe ne kemi një praktikë parlamentare, ku shumë nga rregullimet që parashikohen nuk janë propozim të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, por janë opinione, vlerësime dhe kontribute reale të kolegëve të opozitës dhe kryesisht të kolegut Alibeaj, të cilin gjej rastin ta falënderoj në mënyrë të veçantë, por edhe nga kolegët e tjerë, si Mediu, Mima dhe Haxhinasto. Këto ndryshime kanë ardhur si një

nevojë për të zgjidhur shqetësimet që shërbimet e Kuvendit kanë hasur në punën e tyre të përditshme.

Qëllimet e nismës janë disa. Disa lidhen drejtpërdrejt me rritjen e transparencës në vendimmarrjet tona dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut.

E dyta, që është shumë e rëndësishme, është nevoja e reflektimit të ndryshimeve kushtetuese dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, këtu jemi në shkelje të ligjit për shumë vjet.

E treta, kemi tri detyrime që duhet t'i përmbushim brenda muajit mars. Këtu dua të jem e hapur dhe transparente si për kolegët, ashtu edhe për publikun.

E para, janë rekomandimet e projektit IPA. Bashkimi European ka shpenzuar një shumë të konsiderueshme parash dhe ka asistuar në Kuvendin e Shqipërisë për shumë vjet, edhe në kohën kur Kuvendi është drejtuar nga Partia Demokratike.

Janë shumë rekomandime, të cilat ne i kemi shqyrtuar dhe janë botuar në faqen e Kuvendit, por mbi të gjitha ato kanë të bëjmë me interesin publik. Qytetarët duan të dinë se sa transparent është procesi vendimmarrës, transparenca financiare, konflikti i interesit e të tjera. Por mbi të gjitha, jemi të interesuar ne, sepse të gjithë që jemi këtu nuk duam të baltosemi. Prandaj duhen ndarë deputetët me integritet nga ajo pakicë deputetësh, që kanë probleme në integritetin e tyre.

Rekomandimet e GREKO-s. Më 20 qershor të vitit të kaluar Kuvendi i Shqipërisë mori një vlerësim pozitiv. Mund ta kishim marrë edhe më mirë nëse do të kishim miratuar këtë Rregullore. Pra, jemi ndëshkuar, sepse nuk kemi përmbushur tri rekomandime në këtë Rregullore.

Të nderuar kolegë, këtu kemi një kontribut shumë të mirë të kolegut Alibeaj, i cili ka bërë një sërë amendamentesh, që ishin parashikuar të futeshin në Kodin e Sjelljes me konsensus e të gjithë grupit të ngritur nga Këshilli i Mandateve. E them këtë për transparencë, Këshilli i Rregullores dhe Imuniteteve ka ngarkuar 6 deputetë për të përmbledhur të gjitha opinionet, ku ka qenë zoti Albeaj, zoti Fino, zoti Haxhinasto, zoti Mima, zoti Bushati dhe unë.

Një kontribut të veçantë ka dhënë zoti Angjeli dhe zoti Fino, të cilët i falënderoj, sepse kanë punuar në mënyrë sistematike me Rregulloren.

Ky produkt është bruto dhe është e vërtetë ajo që tha kolegu Alibeaj. A kemi përmirësime? Po. Unë kam bërë amendamentet në emrin tim në konsultim me grupin. Por edhe kolegët tanë kanë amendamente dhe përmirësime, por për transparencë dhe për të ruajtur konsensusin e lamë që të gjitha diskutimet siç i nisëm në grup i punuam jashtë

kamerave në mënyrë konstruktive, kështu të vazhdojmë diskutimin edhe për nenet. Materialin e kemi lënë në atë ditë kur ju ishit në Kuvend dhe u larguat. Por gjatë kësaj kohe, si relatore, kam përgatitur një sërë amendamentesh për të gjitha nenet që mendoj se duhen amenduar, bazuar edhe në sugjerimet e opozitës dhe stafit të Kuvendit, sepse edhe kolegët këtu që kanë një përvojë të gjatë kanë amendamentet e tyre dhe ne duhet t'i diskutojmë në komision.

Në vitin 2017 ne kemi miratuar një vendim, “Ngritja e mekanizmit ndërinstitutional për ndjekjen sistematike të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve kushtetuese dhe atyre të pavarura të krijuara me ligj”, i cili nuk gjen rregullim në Rregullore. Pra Kuvendi punon, stafi i Kuvendit është i përkushtuar, shërbimet e monitorimit punojnë në mënyrë sistematike, ne kemi marrë një vlerësim shumë të mirë në raportin e Bashkimit European dhe nga mekanizmat, kemi punuar me traditë, por pa pasur rregullime në Rregullore. Kjo nuk shkon, sepse ky vendim i Kuvendit duhet të gjejë reflektim.

Nga ana tjetër ne kemi një detyrim tjetër, kemi rekomandimet e bëra në progresraportin e Bashkimit European. Besoj që edhe ambasadori i Bashkimit European, zoti Soreka tha: “Për Kuvendin e Shqipërisë këto katër muaj janë shumë të rëndësishëm” dhe këtu futet reforma zgjedhore, miratimi i Rregullores së Kuvendit dhe fillimi i zbatimit e monitorimit. Pra, ne kemi mundësi që së bashku, sidomos opozita, të monitorojmë qeverinë. Instrumentet që ka Kuvendi janë të shumta dhe ne këtu i kemi përforcuar.

Dua të falënderoj Shërbimet e Përafrimit të Kuvendit, Shërbimin e Seancave, Drejtorinë Juridike dhe Shërbimin e Monitorimit, të cilët kanë qenë shumë të vëmendshëm dhe kanë përfshirë e krijuar çdo instrument për çdo deputet, në mazhorancë dhe opozitë për të bërë këtë proces kontrolli parlamentar.

E fundit, kemi objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe axhendën e vitit 2030. Ne kemi marrë një angazhim dhe jemi një nga parlamentet në avangarde në shumë vende të rajonit dhe më gjerë, të monitorojnë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, premtimet që ka bërë qeveria e mëparshme dhe qeveritë e mëpasshme, me ardhjen tonë në mazhorancë. Është detyrë e Kuvendit që ta bëjmë këtë gjë.

Nga ana tjetër, të nderuar kolegë, do të doja të sillja në vëmendjen tuaj se në Rregullore i jepet shumë rëndësi konstituimit të legjislaturës së Kuvendit. Ka një riformatim të kompetencave të Byrosë së Kuvendit, rritet transparenca dhe teknologjia, dhe, meqenëse pardje është bërë publik edhe raporti i Institutit të Studimeve Politike, besoj të gjithë e keni marrë raportin e zotit Krasniqi, për të cilin ka punuar një staf i gjerë, nga 20 rekomandime të adresuara, 12 rekomandime mund të zgjidhen menjëherë nëse ne do të gjejmë konsensus si mazhorancë dhe opozitë.

Këto rekomandime ose marrja në konsideratë e këtij raporti nuk janë thjesht për të kënaqur organizatat vëzhguese vendase e ndërkombëtare, por adresojnë 5 çështje jetike për shqiptarët dhe raportet tona si të zgjedhur para zgjedhësve.

Së pari, statusin, si i bëjmë detyrat tona si njerëz që na kanë votuar dhe na kanë besuar t'i përfaqësojmë.

Së dyti, transparenca në deklaram, verifikim, në aktivitetin tonë, dhënia fund e abuzimeve që mund të ketë nga deputetë nga përfitime financiare, në falsifikime e të tjera. Forcohet marrëdhënia e besimit të publikut me qytetarin, gjithashtu rritet transparenca e veprimtarisë së përditshme të komisioneve dhe, mbi të gjitha, forcimi i kontrollit parlamentar. Mos harroni që kemi rekomandime shumë të rëndësishme duke filluar që nga KLSH-ja, Avokati i Popullit dhe gjithë komisionerët, të cilët duhet t'i fusim në praktikën tonë. Kemi parashikuar një kre të veçantë sesi do të monitorohen të gjitha rekomandimet e institucioneve të pavarura dhe si duhen thirrur në Kuvend përfaqësuesit e qeverisë, duke filluar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave për llogaridhënie lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve. Nga ana tjetër, edhe ne si deputetë duhet të jemi më të përgjegjshëm dhe duhet të japim llogari para zgjedhësve që na kanë votuar e besuar.

Kemi pasur një debat dhe ka disa çështje për diskutim ku është i nevojshëm konsultimi dhe angazhimi i kolegëve të opozitës. Zoti Alibeaj ka pasur më shumë komente lidhur me rolin e Këshillit të Rregullores së Legjislacionit. Çfarë duhet të ketë në mandatin e vetë për Këshillin e Legjislacionit? Do të shqyrtojnë vetëm ligje dhe projektligje nga këndvështrimi kushtetues apo edhe për çështje të tjera, sikurse ka edhe propozime shumë më interesante për nevojën që kemi për të pasur ekspertizë, sidomos tani në kuadër të përafrimit të legjislacionit edhe për ligje që kërkojnë një ekspertizë, ose të jashtme.

Gjithashtu, e tha me të drejtë kryetari i grupit, zoti Balla, konfigurimi i grupeve, besoj të gjithë duhet ta dimë se nga cilët jemi votuar dhe për cilën parti e koalicion e kemi votën, por nga ana tjetër, ju e dini debatin që kemi bërë kur do të ndaheshin vendet në parlament dhe çfarë debati patëm drejtuesit e komisioneve se kujt do t'i kalonte mandati për vakancën e krijuar kur partia, për shembull, PDIU-ja, ka qenë në maxhorancë dhe më pas kaloi në opozitë.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, i jepet shumë rëndësi monitorimit të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Europian. Më vjen keq ta them, por Kuvendi ka qenë në shkelje që prej vitit 2015. Kemi miratuar një ligj të posaçëm për rolin e Kuvendit në proceset e integritetit, ku Rregullorja bie ndesh me ligjin i vitit 2015 dhe në Rregullore nuk ka dispozita që të përafrohen me një gjë të tillë.

Së fundi, deputetët e Kuvendit kanë disa organizime vullnetare jashtë angazhimeve të komisioneve. Janë Aleanca e Grave Deputete dhe grupi i deputetëve “Miq të fëmijëve”, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, edhe pse nuk ka pasur rregullore. Është punë vullnetare, ekstra, që bëjnë mbi ngarkesën e punës që kanë në komisionet e ndryshme. Këto gjëra kanë nevojë të rregullohen. Ju e dini që regjistrimi i më shumë se 10 mijë fëmijëve në gjendjen civile ishte nismë e grupit të deputetëve “Miq të fëmijëve” ose e kuotave në Kodin Zgjedhor ka qenë nismë e Aleancës së Grave Deputete. Këto rregullime nuk mund të jenë informale, ne kemi Kodin e Sjelljes, duhet të parandalojmë lobizmin, konfliktin e interesit edhe kur kryejmë veprimtari parlamentare, por që është një veprimtari vullnetare.

Më vjen mirë që kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste e shprehu qëndrimin e tij për përshtatjen e Kushtetutës me përshtatjen e saj me Rregulloren. Si juriste, në fakt, ndjehem e keqardhur që kemi frikë që ndryshimet kushtetuese të reflektohen në Rregullore, sepse është detyrim kushtetues, ligjor, çka do të thotë që asnjë rregullore nuk mund të bjerë ndesh me Kushtetutën. Ne kemi bërë një ndryshim, një amendament, bazuar në propozimin e zotit Alibeaj, ju nuk i dini, sepse unë nuk i kam paraqitur ende, të cilat do t'i lëmë në diskutimin nën për nen, rregullimin e procesit të rregullt ligjor, dhe rregullimin e afateve. Pavarësisht se Rregullorja në çdo rast ato aspekte nuk i rregullon, do t'i referohemi drejtpërdrejt zbatimit të Kushtetutës.

Së fundi, te kapitulli shumë i rëndësishëm janë masat disiplinore dhe shkeljet e disiplinës. Ky është një kontribut i madh i opozitës dhe më lejoni ta falënderoj, “Jepi Çezarit atë që i takon”! Ne kemi rënë dakord që mekanizmi i masave disiplinore të mos jetë në Kodin e Sjelljes, por të jetë në Rregullore, sepse Kodi i Sjelljes duhet të ketë një gjuhë miqësore. Më falni, zoti Naço, kontribut të jashtëzakonshëm ka edhe përfaqësuesi juaj, zoti Haxhinasto! Në këtë kuadër, ka një rregullim dhe rishikim të kapitullit “Shkelje disiplinore” për të bërë lidhjen e tyre me Kodin e Sjelljes, këto janë propozime të zotit Alibeaj dhe diskutimi për çdo ndryshim, përmirësim, amendim, qoftë edhe i teknikës legislative duhet të bëhet në praninë e kolegut.

Lidhur me çështjet e tjera, të nderuar kolegë, Kuvendi, në këtë rregullore do të forcojë kontrollin parlamentar lidhur me planet e veprimit dhe strategjitë e miratuara nga Këshilli i Ministrave. Këtu ka një kapitull të veçantë me propozimet e ekspertëve të Bashkimit European, të cilat duhen marrë në konsideratë. Më vjen mirë që nga 30 rekomandime, janë adresuar 23 rekomandime të ekspertëve të Bashkimit European, 7 rekomandime nuk janë adresuar, sepse janë përsëritje e rekomandimeve të mëparshme, pra ka

një mbivendosje dhe në tërësi të gjitha rekomandimet e ekspertëve të Bashkimit Europian gjejnë pasqyrim.

Do të ftoja të gjithë kolegët që pas dy hallkave të tjera, diskutimit nën për nën të amendimeve dhe miratimit, të vazhdojmë me dy hallka të tjera: rishikimin i ligjit të statusit të deputetit, që është kërkesë e mekanizmave monitorues ndërkombëtarë, por edhe i Institutit të Studimeve Politike dhe shumë organizata vëzhguese vendase, si dhe ligjit për pavarësinë financiare të Kuvendit. Me këtë rast do të ftoja të gjithë deputetët që kanë *background* në financë për ta bërë këtë gjë dhe mos harroni që në Rregullore forcohet kontrolli i financave të Kuvendit, sepse nuk është më vetëm Byroja e Kuvendit, por hyn në lojë dhe ushtron kontroll Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe seanca plenare. Pra, buxheti i Kuvendit, pas propozimit që bën sekretaria e buxhetit, Byroja e Kuvendit, i shkon komisionit të përbërë maxhorancë-opozitë dhe në fund është seanca plenare. Ne do të votojmë në seancë plenare dhe do të japim llogari si do të harxhohen paratë në Kuvendin e Shqipërisë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Ka pyetje nga kolegët?

Enkelejd Alibeaj – Gjithë kjo që sapo dëgjuat nga zonja Hysi është e vërtetë. Unë dhe zoti Haxhinasto, si pëllumba të bardhë e të shkruar, deri në datën 2 prill po punonim për disa çështje, e mban mend fare mirë ti, një skifter vjen dhe na sjell si propozime pikërisht çështjet e imunitetit (zotëria atje). Janë 6 dispozita të Rregullores që mbajnë firmën tënde. Erdhe ti dhe prishe punën. Ti vjen sot, pothuajse një vit mbas diskutimit dhe thua që tërhiqesh. Shumë mirë bën që tërhiqesh, por çështja është që në materialin e shpërndarë nga Komisioni i Ligjeve e ke të shkruar, po çfarë do të mendonim ne dhe kushdo tjetër, që në materialin që ka përmbledhur zonja Hysi, që është bruto e datës 2 prill, përfshihen edhe nenet 118 dhe 119 të riformuluar, shumë të gjatë madje, që nuk bëjnë gjë tjetër, veçse e rifusin edhe një herë çështjen e imunitetit, që është një nga çështjet më të rëndësishme, që jo vetëm në këtë parlament, po edhe ata që kanë zgjedhur këtë parlament, kanë interes. Në qoftë se jeni tërhequr, ju thashë, ju bën nder. Shumë mirë, por pyetja është pse e propozon ti...?

Sepse, si pëllumba të shkruar, unë me Vasilikën dhe Haxhinaston mund ta vazhdonim punën dhe, në fakt, ne kemi bërë punë.

Shumë mirë bën që më falënderon mua dhe gjithë opozitën, vjet miratimi i Kodit të Sjelljes, që ishte kusht për çështjen e integritetit, që e ngritët me të madhe, ishte kontribut i përbashkët. Po kaq do të duhet të mbani mend edhe çështjen tjetër për të cilën kjo opozitë kishte të gjithë të drejtën për t'u bërë pengesë, pikërisht për pjesën e Rregullores, që vendos

klimën e qetë në parlament. Nuk kam kërkuar asgjë më tepër, por nuk duhet t'i japësh Gramoz Ruçit dhe byrosë së tij të drejtën t'i heq fjalën e të përjashtojë deputetët e opozitës, siç e bëri, meqë ra fjala, edhe në seancën e votimit të gjysmës së qeverisë, apo jo. Ja pra ku është shembulli i respektimit të konsensusit dhe të barazisë. Imunitetin doni ta fusni, heqjen e fjalës nuk e pranoni, meqë ra fjala, përjashtimin e deputetëve të opozitës doni ta bëni kur të doni, këto janë meraket tona.

Për sa i përket çështjes së veprimtarisë së Kuvendit për ta bërë një regjim më intensiv dhe për të qenë edhe për njerëzit, absolutisht ne nuk kemi asnjë lloj problemi. Është opozita e para ajo që e kërkon këtë gjë.

Për çështjet e integritetit sapo ta dhashë shembullin konkret që ishte kontribut edhe yni, i pakushtëzuar, prandaj e meritojmë edhe falënderimin.

Për çështjet e IPA-s, nuk kemi asnjë lloj problemi, pavarësia buxhetore duhet bërë, pavarësi dhe llogari dhënie në bazë performancë. Çështjen për të luftuar korrupsionin e këtij parlamenti, po mbi të gjitha të asaj godine që është përballë, o është kjo opozitë, o nuk është askush tjetër që e ka kërkuar, kurrë të imunitetit, po ta them tani dhe ia kam thënë edhe zonjës, sapo erdhe solle propozimet e tua...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqë jemi në këtë çështje, më 2 prill ka përfunduar, si thatë ju, zonjë, se është material bruto, e pra, duke qenë se është material bruto, i papërpunuar, një vit më parë është e udhës edhe nën atë çfarë zotëria që ju drejton juve tha “*carta bianca*” apo “konsensus”, konsensusi rregullohet në Këshillin për Mandatet dhe Rregulloren, apo jo, kjo është fryma, urdhëroni ta respektojmë Rregulloren. Nuk ka një traditë ky parlament që ta ketë anashkaluar ndonjëherë konsensusin në Këshillin për Mandatet dhe Rregulloren. Filtri i parë gjithmonë ka qenë Këshilli për Mandatet dhe Rregulloren, sepse konsensusi atje garantohet, 5 maxhoranca, 5 opozita.

Çështjet e tjera a kaloi në Komisionin e Ligjeve, apo ku ju keni shumicën, ne nuk kemi asgjë, por ky është testi për të provuar nëse jeni seriozë në ato që sapo thatë, në atë “*carta bianca*”, apo doni të vazhdoni me vrap siç e keni bërë udhë, t'i miratoni me forcën e kartonëve? Ja pra, kjo është kërkesa. Këshillin për Mandatet dhe Rregulloren e thërret Kryetari i Kuvendit, jemi gati për çështjet si integriteti, luftën kundër korrupsionit, çështje për pavarësinë e parlamentit dhe për të drejtën e opozitës dhe për të kontrolluar qeverinë. Ne këtë e kemi kërkuar, jemi gati, jo për çështjet e tjera që kemi futur. Ndaj reflektimin dhe tërheqjen që bën zoti Balla, mirë është ta bësh edhe ti si kryetar komisioni dhe së bashku të merrni vendimin për ta futur në hullinë e Rregullores.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Alibeaj!

Zoti Balla, ju lutem, një përgjigje për pyetjet e zotit Alibeaj.

Taulant Balla – Zoti Alibeaj, që të jemi korrekt me ata që na ndjekin dhe kolegët këtu, diskutimet për Rregulloren e Kuvendit nuk janë ndërprerë për shkak të depozitimit të draftit, përkundrazi, ka që në fillesë drafti që do të thotë se më 2 prill, ti, o pëllumb i shkruar, nuk ike për shkak të depozitimit të 6 neneve, por ishte nevoja që Kuvendi i Shqipërisë kishte për të transpozuar fjalë për fjalë ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 të miratuar me 140 vota në Kuvendin e Shqipërisë në Rregulloren e vet dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese nga vitit 2002 e mbrapa. Jemi një kuvend që ende nuk kemi në Rregullore vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Gjithë kjo është historia.

Mbi bazën e propozimeve të depozituara që në vitin 2017 jo më 2 prill të vitit 2018...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, po flet skifteri, meqë pëllumbi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në datën 27 mars këtu në këtë sallë, pa media, kemi diskutuar dhe të kam thënë që edhe nenet 118 dhe 119 shkruajini vetë, lërin si të doni, por në të drejtën dhe detyrën që ka Kuvendi është që gjithmonë Rregullorja, si një akt i Kuvendit, duhet të reflektojë Kushtetutën. Përsëri jua them, shkruajeni si të doni! Ne do t'ua lemë në letër të bardhë, por nga fjala juaj kuptova që ne qenkemi marrë vesh, jemi dakord, të shkojmë në seancë plenare nesër dhe t'i miratojmë nenet që iu referuat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cila është nevoja? Pse erdhëm te Komisioni i Ligjeve? Erdhëm, sepse në Rregulloren e Kuvendit kemi rënë dakord që kur është miratuar në vitin 2004, që në Këshillin e Mandateve të Rregullores balancat janë të barabarta. Por ku e di unë, zoti Alibeaj, që ti nuk ikën javën tjetër përsëri në bojkot? Kush më garanton që nuk ikën prapë, se edhe këtu ku ndodhesh sot je me marrëdhënie të kushtëzuar, një ditë po, një ditë jo. Nëse ti më jep garancinë që nuk ikën prapë, në Këshill të Mandateve të shkojë, nëse ti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por që t'i çojmë përsëri propozim Konferencës së Kryetarëve që të...

Në fund të fundit, ju dhe kolegët e tjerë këtu, jeni edhe në Këshillin e Rregullores dhe Mandateve. Nevoja qenka e madhe, zotëri, reflektimi i rekomandimeve të komisionit, reflektimi i rekomandimeve të Greko-s, domosdoshmëria që ka Kuvendi për të reflektuar ligjin për rolin e Kuvendit të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian. Të gjitha këto arsye, të cilat ju i miratuat, ne i mbyllim sot dhe nesër mund të shkojmë ta votojmë.

Që të jemi të singertë deri në fund, meqë u hapën petët e byrekut, kur Partia Demokratike dhe vet lideri juaj, Lulzim Basha, ka kërkuar tek unë si kryetar grupi për të ndryshuar Rregulloren, e kemi ndryshuar për dy orë, apo jo, zoti Alibeaj. Në fakt, ka qenë zoti Halimi në vendin tuaj.

Në shtator të vitit 2017 (ore juve nuk ju vjen turp edhe kur gënjeni) zoti Basha më ka kërkuar ndryshimin e Rregullores së Kuvendit, se duhet të gjenim edhe një vend për Tritan Shehun, nënkryetar të komisionit dhe, sigurisht, kemi shtuar që nga një nënkryetar në komisione, kemi bërë dy nënkryetarë. Kuvendi i Shqipërisë e ka miratuar Rregulloren për dy orë, sepse ka pasur konsensus, vullnet politik quhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam qenë edhe unë pëllumb, por tani jam bërë skifter!

Shumë faleminderit, zoti Alibeaj!

Përgëzime për konsesusin e rëndësishëm të arritur sot shpresoj të jetë bazë e shëndoshë që nesër të miratojmë edhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor, të cilat kanë ardhur po ashtu si pjesë e një procesi të rëndësishëm konsultimi me ju. A e shikoni sa të rëndësishëm jeni kur vini në Kuvend?

Ulsi Manja- Faleminderit!

E ka kërkuar fjalën zoti Naço.

Po, zoti Naço, keni fjalën, veçse mos i bëni bashkë pyetjen dhe diskutimin!

Nasip Naço- Faleminderit!

Unë ju jam mirënjohës, më mungonte këshilla juaj. Po them do të bëj dy a tri pyetje, sepse e di që pjesës më të madhe të tyre do t'i përgjigjet kryetari.

Së pari, shpreh gatishmërinë time për të miratuar në parim ndryshimet e Rregullores.

Së dyti, dëgjova kryetarin e grupit parlamentar që interesohet për ne deputetët që të dalim në bazë, pra të kemi ditën e hënë për të folur në lidhje me atë se çfarë marrim ne nga qytetarët. Pyetja ime është: a ka një kosto financiare kjo, e cila më mirë mund të vlejë për studentët ose për dikë tjetër? Pra, këtë që do ta marrin deputetët me dieta dhe shpenzime, a mund ta marrë dikush tjetër?

Me këtë pyetje dua t'i drejtohem zonjës Hysi, edhe si relatore, sepse shikoj që në nenin 13, të Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, në paragrafin e parë thuhet se është i përbërë nga 10 anëtarë dhe në pikën 6 ka një shtesë: “Mbledhjet e Këshillit janë të vlefshme kur marrin pjesë vetëm 5 anëtarë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zonja Hysi, jeni edhe nënkryetare, por është pjesë e procesverbalit dhe draftit që kam mbi tavolinë, por, nëse ju tërhiqeni, po ia bëj pyetjen kryetarit të komisionit. Në nenin 34 të Rregullores thuhet: “Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma, ju sugjeroni që mbledhjet e këtij komisioni të jenë me 5 anëtarë”. Pra, ne sot do të na sugjeroni që nga 140 deputetë edhe me 70 mund ta bëni seancën. Po e kaluat këtë me këtë logjikë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, prandaj ju thashë dy pyetje e gjysmë, sepse isha i sigurtë që këtë përgjigje do të ma jepte kryetari i Komisionit të Ligjeve.

Ulsi Manja- 10 përgjigje do të të jap.

Nasip Naço – Pyetja tjetër ka të bëjë me nenet 118 dhe 119. Unë besoj se ky diskutim ka filluar që në muajin nëntor kur për një nga deputetët e maxhorancës ka ardhur kërkesa në komision për t’i hequr mandatin. Janë bërë debate të mëdha në këtë komision, maxhoranca edhe në komision, edhe në parlament ka marrë përsipër të bëjë rolin e gjykatës dhe prokurorit.

Në draftin e paraqitur nuk është e shkruar, siç është Kushtetuta dhe Kodi i Procedurës. Pra i keni bërë dy amendamentet, nenin 6 dhe nenin 8 ku kërkon që ky Këshill të jetë i barabartë me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po ju pyes: si e keni menduar këtë Këshill, ta bëni gjykatë, prokurori?

Ulsi Manja- Zoti Balla, ju lutem, një përgjigje për koston financiare të ndryshimeve të Rregullores.

Taulant Balla- Faleminderit, zoti Naço për mundësinë që më dhatë për të sqaruar më mirë propozimin për riprogramimin e muajit parlamentar të deputetëve. Propozimi është tërësisht i bazuar në modelin e Parlamentit Europian, i cili, sipas mendimit tim, është modeli më i mirë, sepse është edhe i ri. Modeli gjerman mund të kishte qenë një mundësi me nga dy javë, por modeli i Parlamentit Europian kompozohet nga 4 javë parlamentare, 3 javë janë punë intensive dedikuar përgatitjes dhe shqyrtimit të legjislacionit, dhe një javë u është dedikuar zgjedhësve. Si e tillë, java e 4-t fillon pikërisht me një seancë ditën e hënë pasdite dedikuar javës që parapriu dëgjuesat me njerëzit dhe zgjedhësit gjatë të gjithë javës. Kjo do të thotë se në atë seancë çdo deputet ka në dispozicion foltoren e Kuvendit për të sjellë aty shqetësimet. Rregullorja e Kuvendit asnjëherë, në asnjë rast, nuk është dokumenti që parashikon nevojat financiare. Rregullorja e parlamentit është libri i rregullave, që sanksionon funksionimin.

Ajo që unë ju thashë dhe ju nxita është që në këtë frymë konsensusi të sotëm të ngrihet një grup pune i përbashkët me të gjitha grupet parlamentare, siç kemi bërë edhe për ligjin për pavarësinë buxhetore të Kuvendit, edhe për ligjin për statusin e deputetit. Të dy janë të domosdoshëm për të reflektuar nevojën e funksionimit normal të deputetit.

Media të caktuara, me ose pa qëllime të mira, çdo herë transmetojnë se si zyrat e deputetëve në zona të caktuara nuk janë funksionale. Që zyrat të jenë funksionale duhet që deputeti të jetë në zonë. Unë mendoj që propozimi që kemi sjellë për t'i dedikuar një javë në muaj tërësisht prezencës së deputetit në zonën zgjedhore është hap i rëndësishëm. Europarlamentarët janë i njëjti shembull, ku pas dy javëve në Bruksel, një në Strasburg, java e tretë i dedikohet prezencës në zonën zgjedhore.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Kush e do fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Atë e vendos vota. Vota në fund e ndan grupin e punës nga komisioni. Po diskutoni sikur po miratoni Rregulloren për t'u mbledhur parlamenti në Hënë. E kuptoni se çfarë shfaqjeje bëni ? Sikur po punoni për një Rregullore që parlamenti i Shqipërisë të mbledhet në hënë. 65 nene të Rregullores do të rishikohen.

Zoti Veliaj, keni fjalën.

Astrit Veliaj – Unë kam një propozim. Për javën e katërt që do të shkohet në bazë, mendoj që të mos e humbasim traditën e bërjes katër herë parlament në Kuvend, ta bëjmë të hënë e asaj jave dhe e marta, e mërkura të jetë në bazë, pra të kemi 4 herë parlament në muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Kolegë, ju lutem, zoti Veliaj ka marrë fjalën dhe do të flasë.

Astrit Veliaj - Seanca plenare të bëhet ditën e hënë në javën e katërt, e cila është për të shkuar në bazë dhe të martën të shkojmë në bazë.

Ulsi Manja – Relatorja ta mbajë shënim propozimin e zotit Veliaj.

Taulant Balla– Diskutimi që kemi bërë edhe me kolegët e Partisë Demokratike për këtë çështje ka qenë i bazuar në arsyen që të shkuarit në zonë duhet të shoqërohet me një moment të menjëhershëm për të sjellë problematikat që konstatohen. Pra, ti nuk mund të shkosh nga seanca në zonën zgjedhore, por vjen nga zona zgjedhore dhe shprehesh në seancë. Pra, seanca e dedikuar është të hënë dhe koha në dispozicion fillon të premtën me përfundimin e seancës së të enjtes dhe mbaron pas 10 ditësh, të hënë pasardhëse. Pra, numri i seancave nuk ndryshon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Ju lutem, zoti Fino, për procedurë.

Bashkim Fino- Unë mendoj që Rregullorja është jona, nuk është as e grupit të PS-së, as e grupit të PD-së, as e LSI-së. Në këtë kontekst na bëri mirë ky mësim tregues i mëparshëm qoftë i fjalës së zotit Alibeaj, qoftë e zotit Balla. Unë nuk po falënderoj njeri se u bënë shumë falënderime, u bënë pingpong falënderimesh.

Tani, meqenëse të gjithë ramë dakord me këtë projektregullore, ramë dakord në të gjitha pikat, qoftë me rekomandimet e Bashkimit Europian, qoftë me ato që kemi vendosur ne, unë propozoj që në këta që u falënderuan më shumë, zotin Alibeaj dhe zonjën Hysi, unë mendoj të fusim edhe zotin Naço, që ta marrin këtë draft që kemi, ta shikojnë nen për nen dhe pastaj të na e sjellin këtu që të miratohet me konsensus të plotë nga 140 deputetët.

Me sa duket nuk kemi vërejtje thelbësore që të jemi kundër projektregullores. E mbyllim në parim këtu duke menduar se jemi dakord me projektregulloren në parim, por nen për nen të na vijnë me këto tri firma në Komision të Ligjeve.

Nëse PD-ja, e dëgjova me kënaqësi zotin Alibeaj këtu dhe unë e respektoj për çështjet juridike, do patjetër ta çojë në Këshillin e Mandateve, jemi dakord.

Ne nuk duam, zoti Alibeaj, që të tregojmë forcën e kartonit që jemi më shumë në Komisionin e Ligjeve, sepse do të vijë puna të votoni në seancë plenare, ku duhet edhe vota ime edhe jotja dhe nuk kemi asnjë interes që ta kalojmë këtu me shumicën e kartonit.

Unë them që këtë draft ta shikoni nen për nen dhe të bëni vërejtjet përkatëse, ju, si grup pune nga Komisioni i Ligjeve që jeni juristë. Ne jemi dakord të gjithë si të kalojë këtu, si të kalojë në komisionin tjetër, për mua pak rëndësi ka, sepse rëndësi ka që në seancë plenare kjo do të kalohet me 140 deputetë, siç u kalua reforma në drejtësi.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Fino! Ma thjeshtove edhe mua punën. Në rendin e ditës sot kemi miratimin në parim të ndryshimeve të Rregullores, që do të thotë komisioni shprehet në parim që biem dakord që Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë do të amendohet në disa nene të caktuara.

Unë mendoj që të bëhen 3 bashkërelatorë, po deshët e quajmë grup pune, e miratojmë sot në parim ndryshimin e Rregullores, pastaj ky grup pune, që do të ngrihet, të punojë për ndryshimet nen për nen, por edhe deputetë të tjerë të Kuvendit që kanë propozime për ndryshimet në Rregullore ta na i sjellin në Komisionin e Ligjeve, dhe atëherë komisioni do të vendosë nëse do ta miratojë këtu apo do t'ia çojë Këshillit të Mandatave dhe të Rregullores ta shqyrtojë nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti do ta bllokosh punën tani?

Enkelejd Alibeaj – Ishte propozim shumë i mirë, konstruktiv ai i zotit Fino dhe i zotit Naço. Merreni për bazë atë që thotë zoti Fino, sepse këtu nuk është çështja të jemi dakord apo jo, por duhet ta diskutojmë. Në ato kushte që unë thashë tërhiqen të gjitha propozimet për çështjet e imunitetit, këtë e them që tani unë në emër të opozitës, por si provë që realisht doni ta miratoni me konsensus, pa prishur traditën dhe pa thyer Rregulloren, e vetmja gjë që mund të bëni është të merrni për bazë atë që thotë zoti Fino, pra kalojeni te Këshilli për Mandatet dhe Rregulloren, siç e thotë Rregullorja. Kjo është çështja.

Nuk kalohet në parim dhe pastaj nëse nuk ju pëlqen pazari e miratoni me forcën e votave. Keni dhënë prova që ju nuk i qëndroni asgjëje. Respektoni Rregulloren dhe zotin Fino! Tërhiquni nga çështja e imunitetit dhe kalojeni te Këshilli i Mandateve.

Bashkim Fino- Ju lutem, shumë mos bëni retorikë politike kot tani dhe mos na harxho kohën kot! Le të bëjmë pak punë të mirëfilltë. Çfarë po thua ti? Kryetari i grupit tim parlamentar që është këtu prezent të “*la letër të bardhë*”, të tha se nuk ka asnjë problem me imunitetin, të jetë siç është në Kushtetutë, ashtu siç e do ti. Ne themi jemi plotësisht dakord, e kalojmë thjesht në parim dhe ju si grup pune i merrni, i shikoni edhe një herë nen për nen, vini në seancë dhe i votojnë 140 deputetët. Tani mos bëni lojëra, se nuk e kemi kohën e tepërt.

Ju lutem, zoti kryetar, bëra një propozim, hidheni në votim.

Enkelejd Alibeaj - Edhe një herë zoti Fino dhe të gjithë zotërinjtë që jeni këtu, ne nuk kemi nevojë për “karta bianka” ne kemi nevojë të respektojmë Rregulloren, sepse, siç e the, zotërore, kjo nuk është Rregullorja e PS-së, PD-së, LSI-së, por është e parlamentit, që do të thotë interesin kryesor e kemi ne, por e ka edhe media, edhe publiku. Me këtë rast duhet të japim shembullin, se sa ky parlament respekton Rregulloren dhe Kushtetutën. Kjo kërkohet. Kjo është provë që ne e kërkojmë që, meqë ra fjala, nesër në seancë, të mos e bëni në mënyrë të njëanshme, siç e keni bërë rrugë.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Alket Hyseni – Këtu po abuzohet me çështjen e Rregullores, e cila e shpreh qartë që nuk i ngarkon Këshillit për Rregulloren dhe Mandatet shqyrtimin e ndryshimeve të Rregullores.

Neni 13 është i ndarë në dy pjesë, në dy paragrafët e parë ka kompetencat deklarative: “studion dhe jep mendim”, kurse aty ku Kuvendi ka dashur t’i japë kompetenca shqyrtimit, janë pikat 3 dhe 4 ku thuhet se Këshilli shqyrton dhe ia përcjell seancës. Kështu që të mos abuzojmë me Rregulloren, nuk e ka fare detyrim Rregullorja që të kalojë nga

Këshilli. Këshilli e ka pasur të gjithë kohën, mund të mbledhet me një seancë, ta studiojë dhe të japë mendim, është çështje tjetër, por detyra është e këtij komisioni. Ne e ezauroam këtë. Ngremë grupin e punës së këtij komisioni, është kërkesë procedurale dhe vazhdojmë shqyrtimin nen për nen.

Fatmir Xhafaj – Unë mendoj që momenti i diskutimit të ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit është një moment i rëndësishëm për çdo deputet dhe Kuvendin si institucion dhe është ligjshme që të marrë interesin maksimal të trupës së deputetëve, por edhe të opinionit publik. Nëse dikush ka qëllim ta kthejë në kakofoni, unë mendoj se ia arriti për shkak të faktit që nuk kuptuam ku ishin pyetjet, ku ishin ndërhyrjet, ku ishin diskutimet në funksion të këtij projekti që është paraqitur. Duke qenë se këtu ka edhe deputetë që duan të flasin në parim për këtë dokument të rëndësishëm, duke qenë se koha, me sa po kuptoj unë, është e limituar për shkak të faktit që do të ketë një Konferencë Kryetarësh në të njëjtën orë dhe ajo prevalon nga pikëpamja e rëndësisë që ka, unë do t'ju sugjeroja që ta ndërpresim këtu këtë seancën dhe ta lëmë ndonjë ditë tjetër në javën në vijim për ta diskutuar në parim këtë çështje.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Xhafaj!

Edhe unë jam i mendimit që vazhdimi i diskutimit në parim i projektndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit të shtyhet për në mbledhjen e radhës, ndaj do të kërkoja mirëkuptimin e kolegëve. A jemi dakord që ta shtyjmë diskutimin mbledhje e radhës?

Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Atëherë vazhdimi i diskutimit në parim dhe i miratimit në parim të ndryshimeve në Rregullore do të bëhet në mbledhjen e radhës.

Faleminderit!